



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.318, datë 16.12.2022

PËR  
“EMËRIMIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR  
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR”

Bazuar në nenet 148/dh dhe 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 52 pika 1 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 15 të ligjit Nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18, 19 dhe 20 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë prokurorisë së posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” e ndryshuar, pasi zhvilloi seancën dëgjimore ku u drejtuan edhe pyetjet përkatëse kandidatëve Adnan Xholi, Altin Dumani dhe Edvin Kondili, si dhe pasi votoi në rend alfabetik secilin prej tyre nga ku rezultoi se kandidati Adnan Xholi mori 1 votë, kandidati Altin Dumani 5 vota dhe kandidati Edvin Kondili 4 vota, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Altin Dumani, emërohet drejtues në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Mandati i zotit Dumani si drejtues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar do të jetë 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhje, duke filluar nga data 19.12.2022 deri më datë 18.12.2025.
3. Të njoftohen për këtë vendim, zoti Dumani dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e shpalljes dhe publikimit zyrtar të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 16.12.2022.



KRYETAR  
Alfred Balla

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**  
**Bujar Sheshi**

**ANËTAR**  
**Nurihan Seiti**

**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**

**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**

**ANËTAR**  
**Arta Mandro**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

